



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1378/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj –Sheremeti, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit sh.p.k, me nr. biznesit 810013665, me seli ne Drenas, adresa “...”, ndaj debitorit “...” me numër fiskal me seli ne Pejë, adresa “...., me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.655/19 të datës 18.06.2019, me datën 06.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “...”, me numër fiskal me seli ne Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.655/19 të datës 18.06.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.655/19 të datës 18.06.2019, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit shpk Pejë, i paraqitur kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat Isak Islami në Prishtinë P.nr.05/19, të datës 07.03.2019.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit jo te plotë dhe te gabuar te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovtoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e shkalles se parë ta prish dhe lëndën ta kthej ne shkallë te parë për rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori edhe pse ankesën e ka pranuar me datën 21.10.2021

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturë me nr.20170191 datës 05.07.2017. Përmbartuesi privat Isak Islami nga Prishtina sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr. 05/2019 të datës 07.03.2019, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën prej 1 690.80 euro.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 25.03.2019, duke theksuar se ka bërë pagesën me datën 25.08.2017 në xhirollogarinë e kreditorit në shumën prej 1 690 euro në emër të biznesit, por pas datës se pagesës kreditori e njofton se nuk është dashur të bëhet pagesa në atë xhirollogari bankare për arsye se përmbartuesi privat i ka bllokuar llogarinë dhe nuk mund ti tërheqë paratë e deponuara. Biznesi e ka ndërruar emrin e biznesit dhe xhirollogarinë bankare por pronari mbetet i njëjtë. Meqë nuk ka pasur njoftim paraprak për ndryshimet e kreditorit atëherë pagesa i është bërë në emër të biznesit, andaj edhe pretendon se nuk ka borxh ndaj kreditorit pasi pronari mbetet i njëjtë. Propozon që aktvendimi i ankimuar të shfuqizohet duke i ndërprerë të gjitha veprimet e deritanishme dhe propozimi i kreditorit të konsiderohet padi ndërsa kundërshtimi i debitorit të konsiderohet përgjigje në padi.

Në një parashtesë të datës 27.03.2019 subjekti shpk me numër fiskal deklaron se nuk ka asnjë dëshmi se pagesa është kryer në llogarinë tonë dhe se furnitori nuk ka të bëjë asgjë të përbashkët me shpk apo, janë të ndryshme, me numër fiskal, numër xhirollogarie, pronar dhe të gjitha, se fatura me të cilën është pranuar malli në SHPK është shumë e qartë sa i përket furnitorit, numrit të llogarisë dhe të dhënave.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të prapësimit, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.655/19 të datës 18.06.2019, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së urdhri për lejimin përmbartimit është lëshuar në bazë të faturës nr.20170191 të datës 05.07.2017 konform nenit 29 par.1 .3 të LPP. Nuk qëndron pretendimi i debitorit se kreditori nuk e ka informuar paraprakisht për ndërrimin e emrit të biznesit dhe numrit të xhirollogarisë bankare, nuk mund të pranohet si e qëndrueshme sepse fatura e datës 05.07.2017 i përmban të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me emrin e xhirollogarisë së kreditorit dhe e njëjta është pranuar dhe nënshkruar nga kreditori. Andaj gjykon se në pajtim me nenin 69 par.5 të LPP lidhur me neni 71 par.1.1 të LPP, ashtu që nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulim të urdhrin përmbartues.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbareuesit privat, me të cilin është caktuar përmbareimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbareimi është lejuar në bazë të faturës origjinale të lëshuar nga kreditori, e cila faturë në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe e njëjta si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbareimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbareim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se “kur propozimi për përmbareim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimi të bashkëngjitet dokumentit të origjinal apo kopja e tij të vërtetuar sipas ligjit” çka edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se kreditori ka vepruar në pajtim me këtë nen, e kjo duke vepruar sipas dokumentit të besueshëm-faturës, në bazë të së cilës është caktuar përmbareimi.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së. Kjo gjykatë po ashtu vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës, të cilën kreditori ia ka bashkëngjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbareim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbareimit të propozuar nga kreditori, ngase fatura nr.20170191 të datës 05.07.2017 në bazë të së cilës është caktuar përmbareimi, ligjërisht paraqet bazë juridike për caktimin e përmbareimit. Nuk qëndron pretendimi i debitorit se me rastin e pagesës së bërë në llogari të kreditorit nuk ka qenë në dijeni nga i njëjti për ndryshimin e emrit të biznesit dhe të numrit të xhirologarisë sepse debitori faturën me numër .20170191 të datës 05.07.2017, në emër kreditorit ..., e ka pranuar edhe nënshkruar dhe se e njëjta faturë përmban të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me kreditorin si dhe numrin e llogarisë bankare, nga rezulton se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm. Më të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij të paraqitura në prapësim. Andaj gjykon se në pajtim me nenin 69 par.5 të LPP lidhur me neni 71 par.1.1 të LPP, nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulim të urdhrin përmbareues..

Në procedurën përmbareimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbareimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës

dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbareues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,
DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.1378/22, me datë 06.10 .2022

Gjyqtarja,
Sarada Bogaj - Sheremeti